



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
03.03.2025**

Me datë 03.03.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Hilmi Lakti, Erald Erkocaj, Vjollca Petani, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Gëzim Galiqi, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Gjenarin Kapcari, Eliona Shkrela, Elis Doci, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Ardita Spahija, Gjovalin Ndoj, Samed Bushati, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Plarent Anamali, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2025".*
2. *Pr/ Vendim: "Për strehimin emergjent të Znj.G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish –Konvikti i Shkollës veterinare).*
3. *Pr/ Vendim: "Përditësim të VKK Bërdicë nr. 29, datë 06.05.2008 " Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë " të miratuar me VKM nr.895, datë 10.11.2010, " Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës", dhe inventarizimin e pasurisë me nr.383 volum 1, faqe 207 ZK 1157.*
4. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e Kërkesës të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr.2/204, nr.2/699, ZK 8593, pasurive me nr.3/733 dhe nr.3/957 ZK 8591".*
5. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencive funerale/shtëpi funerale (Salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër".*

6. *Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.*
7. *Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024.*
8. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Shtesë rendi dite:

1. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e Kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me Nr.3/455, vol 30, FQ 142 Gjykata e rrethit Shkodër nga Ministria e drejtësisë tek Bashkia Shkodër".*
2. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e shkëmbimit të pasurive midis Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Brendshme".*

Kourumi i domosdoshëm është present në salla, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Luli prezanton rendin e ditës, duke shtuar se ka patur një kërkesë, e cila lidhet me mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 06.11.2024.

Ndërhyn **Z.Gjergj Sokoli** duke thënë se edhe ai kërkon fjalën për të njëjtën kërkesë.

Z.Luli shton se në mbledhjen në fjalë është propozuar nga **Z.Bjanku** shtyerja e Pr/ Vendimit: "*Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik, në territorin e Bashkisë Shkodër*". Prandaj ai i kërkon këshilltarëve, që kanë bërë kërkesën në fjalë, ta depozitojnë atë pranë sekretarisë së Këshillit në mënyrë që të bëjnë të mundur që ky pr/vendim të kalojë për miratim mbledhjen e ardhshme.

Përsëri **Z.GJ.Sokoli** shprehet se në emër të grupit të PSD, se ka patur mjaftueshëm afat për ta miratuar tashmë. Pr/vendimi ka firmën e Kryetarit të Bashkisë prandaj kërkon që ky pr/vendim të merret në konsideratë dhe të hyjë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje, sepse ka shumë kërkesa që presin në sirtar për vendosje të veprave të artit dhe kjo vonesë nuk është aspak normale.

Z.Bjanku në lidhje me Rregulloren në fjalë shprehet se është e vërtetë se unë kisha disa sugjerime për tekstin, pasi kishte disa mospërputhje por beson që ka qënë e gjithë koha e mjaftueshme që ky ky pr/akt të përfshihej në rendin e ditës. Prandaj edhe grupi i tyre politik shprehet pro kalimit të tij për miratim në këtë mbledhje. Ai shton se kërkesat e tij kanë qënë në lidhje me formulimin e teksit të rregullores dhe mendon se duhej të ishin reflektuar tashmë.

Z.Luli pyet nëse nga ana e tij ka patur ndonjë sugjerim meqënëse ka qënë ai që ka kërkuar shtyerjen e miratimit të pr/vendimit.

Përsëri **Z.Bjanku** shton se ne nuk kishim ndonjë problem substancial me të, thjeshtë duhet të ndërhyhet në tekst për të shmangur keqkuptimet.

Z.Ndou shprehet se edhe grupi i Partisë Socialiste është dakort ta kalojnë për miratim nëse nuk ka probleme madhore.

Z.Luli përsëri thotë se nuk ka kundërshtime por nuk ka patur asnjë kërkesë më shkrim nga ana e ndonjë këshilltaripër përfshirje e kësaj pike në rendin e ditës. Kemi patur vetëm kërkesa nga Kryetari i Bashkisë për shtesa, kështu që kemi të bëjmë me një vakum të tillë, që pavarësisht dëshirës së mirë nga ana jonë, një gjë e tillë nuk është e parashikuar në rregulloren e Këshillit.

Z.Gj.Sokoli se duhet ta hedhim në votim nëse duhet të përfshihet sot ky pr/vendim.

Z.Luli përsëri shprehet se këtë nuk e parashikon Rregullorja.(citon këtu pikën 2. të saj)

Ndërhyn **Z.Gj.Sokoli** duke thënë se në dijeninë e tij rregullorja ka edhe një pikë ku anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të sugjerojnë dhe të propozojnë një gjë të tillë.

Përsëri **Z.Luli** i referohet Rregullores duke cituar nenin 47 të saj, që duhen minimalisht dy ditë që të paraqitet një kërkesë e tillë me shkrim.

Znj.Shkrela shprehet se nuk është hera e parë që shkelet rregullorja, pastaj mbledhja nuk mbaron për 5 minuta, kështu që Kryetari i Bashkisë dhe stafi i tij mund ta përpilojnë një kërkesë dhe ta sjellin për miratim.

Z.Lesha, drejtor i përgjithshëm juridik shprehet se pr/vendim tashmë ndodhet në sekretarinë e Këshillit dhe përderisa anëtarët janë dakort, ne si Bashki nuk jemi kundër që ky Pr/vendim të fute në rendin e ditës.

Z.Luli pyet nëse zyra juridike mund të bëjë ndonjë interpretim ligjor në dakordësi me rregulloren e Këshillit dhe me ligjin në këtë rast?

Z.Lesha përsëri thotë se nëse të gjithë anëtarët janë dakort për ta shtuar këtë pikë, beson që është e mjaftueshme për të vijuar procedurën.

Z.Luli, pra po thoni që jeni dakort të vazhdojmë në shkelje me Rregulloren?

Z.Gjergj Sokoli shton se përderisa edhe zyra juridike është dakort, beson se edhe nga ana ligjore jemi në rregull.

Fjalën e merr **Znj.Nika** e cila shprehet se kur ka patur gjithë ato debate dhe kërkesë për shtyerje të këtij pr/vendimi për gabime ortografike nuk ka ka sens të kalojë tani, sepse do të thotë ta gjejmë veten në gabim.

Znj.Mehmetaj gjithashtu mendon që materialin e kemi të gjithë, por u kthye për ndryshimet e nevojshme. Ç'kuptim ka tani ta miratojmë të pandryshuar?

Z.Bjanku merr përsëri fjalën dhe thotë se po përmendet shumë opozita. Ai kërkon të bëjë të qartë që ai ka kërkuar përmirësimin e materialit, pasi nuk ishte serioze që institucioni i Bashkisë të miratojë në atë mënyrë. Në dijeninë e tij edhe drejtori juridik ka dal në media duke thënë se pr/vendimi është rishikuar dhe është në sekretarinë e Këshillit bashkiak.

Z.Shkjau shprehet se duhet zbatuar Rregullorja se Këshilltarët mund të shkrijnë Këshillit e jo më tepër.

Z.Anamali shprehet se vendimi duhet të marrë ligjshmërinë e Prefektit të qarkut dhe nëse ka paligjshmëri kjo do të çojë automatikisht në anulimin/shfuqizimin e tij. Prandaj kërkon zbatimin e Rregullores së Këshillit.

Z.Luli pyet nëse nga ana e Komisionit të ligjeve ka ndonjë qëndrim?

Z.Ndou shprehet se nëse është e nevojshme mund të kërkojmë 5 minuta pushim.

Z.Gjergj Sokoli përsëri shprehet se edhe në respekt të atyre që agjërojnë, mendon që duhet të hidhet në votim.

Z.Bjanku qartëson se nëse dokumenti nuk është redaktuar ka nevojë për ndërhyrje.

Replikon **Z.Lesha** duke thënë se për ndërhyrjet që po flitet duhet të na i kishit sjellë ju Z.Bjanku me shkrim që ta dimë edhe ne se ku janë këto elemente. Ne jemi të hapur për bashkëpunim, por ju në asnjë moment nuk kenë thënë se ku ka probleme.

Z.Bjanku përgjigjet duke thënë se duhet të tregohemi të përgjegjshëm për përgjigjet duke thënë se duhet të tregohemi të përgjegjshëm për çfarë flasim dhe nuk duhet të bëhen aludime.

Z.Gj.Sokoli kërkon edhe njëherë që të hidhet në votim.

Z.Luli thotë se do hidhet në votim kërkesa për përfshirjen e këtij pr/vendimi në rendin e ditës, ku rezultojnë **29** vota Pro **2** Kundër **3** Abstenim. **Miratohet**

Përpara se të vijohet me votimin **Z.Anamali** shprehet në lidhje me pikat e tjera të parashikuara për këtë mbledhje, konkretisht për Këshillin artistiko-kulturor duke thënë se pjesë e tij nuk mund të jetë një punonjës i Bashkisë, pasi jemi në kundërshtim me dispozitat ligjore (VKM 540/1992 dhe ligjin për Këshillat kulturorë të Kryeministrit) Më parë duhet sistemuar kjo pjesë.

Z.Luli sqaron se me Udhëzimin e vitit 2025 të Kryeministrit nuk ka asnjë kundërshtim.

Për më tepër sqaron për këtë **Znj.Leqejza** duke thënë se në këtë Udhëzim është e shprehur shprehimisht që njëri ka anëtarët duhet të jetë punonjës i drejtorisë së Kulturës.

Hidhet në votim rendi i ditës me shtesat e propozuara, ku rezultojnë **31** vota Pro **1** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Para se të kalohet tek pika e parë e rendit të ditës, hidhet në votim miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.01.2025, ku rezultojnë **32** vota Pro **0** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Z.Pode shprehet se për pikën e parë dhe të dytë nuk ka nevojë për relativim.

Z.Luli përgjigjet se në zbatim të rregullores, do t'i lexojë një nga një.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen pro Pr/vendimin.

Pr/akti "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2025" hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e dytë: Pr/ Vendim: "Për strehimin emergjent të Znj.G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish –Konvikti i Shkollës veterinare).

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen pro Pr/vendimin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: Pr/ Vendim: "Përditësim të VKK Bërdicë nr. 29, datë 06.05.2008 " Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë" të miratuar me VKM nr.895, datë 10.11.2010, " Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës", dhe inventarizimin e pasurisë me nr.383 volum 1, faqe 207 ZK 1157.

Relaton për këtë **Z.Alban Preka**, drejtor në drejtorinë e aseteve në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.I.Sokoli pyet sa për saktësim nëse prona në fjalë është në pronësi të Ministrisë aktualisht.

Përgjigjet Z.Preka duke thënë se aktualisht kemi të bëjmë me një pronë pa pronar por nga kërkimet që janë bërë ajo është përdorur historikisht si fushë sportive. Nga verifikimet e kryera ajo nuk është pjesë e inventarizimit të pronave shtetërore.

Për tepër sqaron edhe **Zv/Kryetari Bejleri** duke thënë se po kërkojmë që kjo pronë e parregjistruar t'i kalojë Bashkisë Shkodër. Qëllimi jonë është për ta bërë një fushë sportive.

Z.Behri pyet se pas kalimit nga kush do administrohet, nga Bashkia apo ekipet që do stërviten aty?

Përsëri përgjigjet **Zv.Kryetari Bejleri**, duke shtuar se fusha do jetë në administrim të Bashkisë Shkodër dhe në bazë të një kalendari beson që do t'i vihet në dispozicion ekipeve.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen pro Pr/vendimin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën 4. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për miratimin e Kërkesës të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr.2/204, nr.2/699, ZK 8593, pasurive me nr.3/733 dhe nr.3/957 ZK 8591.

Relaton përsëri **Z.Alban Preka**, drejtor në drejtorinë e aseteve në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku shprehet se vëren se nuk ka një plan vendosje të këtyre 5 pronave, ndërkohë që tek pika e sipërpërmendur kishim.

Sqaron **Z.Preka** duke thënë se bëhet fjalë për dy raste të ndryshme. Në rastin konkret, kemi vetëm miratimin e kërkesës.

Vijon **Z.Bjanku** duke thënë se nëse flasim për konviktin e Universitetit, aty kemi edhe Bibliotekën, që është në pronësi të Universitetit. Si do procedohet në vazhdim?

Z.Preka thotë se transferimi bëhet në bazë të gjendjes faktike. Merret statusi juridik dhe të gjitha pronat që rezultojnë të parregjistruara në pronësi të të tretëve do i kalojnë konviktit.

Z.Bjanku shprehet se në dijeninë e tij ndërmmarrja e trajtimit të studentëve ka patur në pronësi godinat dhe jo vetëm, ndërkohë që po flasim për të njëjtin objekt, ku ka një parking me pagesë nga ana e kësaj ndërmmarrjeje. Si mundet të ndodh kjo pa kaluar në pronësi?

Z.Preka thotë se beson që po flitet për dy gjëra të ndryshme. Kjo mund të shërbejë edhe për të zgjidhur këtë pjesë. Sqaron më tej edhe **Zv/ kryetari Bejleri**, duke thënë se mospatja e lidhjes së truallit me objektin nuk na lejon të vazhdojmë më tej...

Z.I.Sokoli thotë se pr/vendim thuhet se qëllimi që në të ardhmen të bëhen investime, çfarë investimesh priten të bëhen konkretisht?

Zv/kryetari Bejleri thotë se momentalisht është në fazë studimi për t'i hap rrugë më vonë investimeve.

Znj.Nika shprehet se sa për sqarim, bëhet fjalë për një pronë pa "identitet" ndër vite, pra në këtë mënyrë po i hapim rrugën një procesi, jo vetëm ligjor por si detyrim qytetar. Prandaj duhet përgëzuar drejtorja e Aseteve dhe Bashkia Shkodër për këtë nisëm.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, **Z.Ndou**, **Z.Sokoli** janë dakort me pr/aktin. Kurse **Z.Bjanku** shprehet kundër, pasi dokumenti është i paplotë.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **27** vota Pro **6** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencive funerale/shtëpi funerale (Salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër"*.

Relaton përsëri **Z.Lesha**, drejtor i përgjithshëm juridik, në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.I.Sokoli përshëndet vendimin, por shton se kjo hap rrugë diskutimit tjetër që ka të bëjë me ligjin e planifikimit të territorit për përdorimet dhe përputhshmëritë. Të njëjtën gjë duhet kemi edhe për pikat e karburanteve. Ai shprehet se është i gatshëm të kontribuojë për këtë.

Z.Gj.Sokoli, shprehet në lidhje me sa tha **Z.Lesha** duke thënë se ato kanë qënë vetë present në dëgjuesën publike, dhe e gëzon shumë fakti që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin dakort me rregulloren.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, **Z.Ndou**, **Z.Sokoli** janë dakort me pr/aktin. Edhe **Z.Bjanku** shprehet pro, por ai shton se duhet të kemi parasysh se shpesh miratojmë akte që në formë janë të rregullt, por e rëndësishmja është që zbatimi të kryhet për të gjithë njësoj.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 6 të rendit të ditës: *Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin*

e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Relaton për këtë pikë **Z.Pandi Laço**, drejtor i përgjithshëm i Kulturës në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shkrela merr fjalën dhe përgëzon për përzgjedhjen dhe vlerëson personalitetet , por dëshiron të ndalet tek jeta kulturore artistike e qytetit. Me datë 15.02.2025, shton ajo është hapur konkursi për instrumentistët e orkestrës simfonike...

Ndërhyn **Z.Luli** duke thënë se kjo nuk a lidhje me pikën që po diskutohet...

Vijon përsëri **Znj.Shkrela** duke kërkuar një përgjigje nga Z.Laço.

Z.Luli sqaron përsëri se në komisionin e Kulturës mund të ishin bërë të gjitha pyetjet apo diskutimet që kërkoni. Së pari miratohen pr/vendimet pastaj kalojmë në diskutime të tjera.

Edhe **Znj.Nika** shprehet se pyetjet janë jashtë tematikës së pr/aktit.

Znj.Petani shprehet se nuk duhet të merremi me vogëlsira.

Replikon **Znj.Shkrela** duke thënë se duhet të kemi kujdes me fjalorin kur flasim.

Z.Luli tërheq vëmendjen duke i thënë se nuk i është dhënë fjala.

Z.Bjanku ka një pyetje në lidhje me procedurën që ndiqet në përzgjedhjen e këtyre personaliteteve, sepse para ca kohësh kishim dy emra të tjerë dhe sot vërejmë ndryshimi.

Përgjigjet **Z.Laço** duke thënë se meqënëse personaliteti i parë i përzgjedhur u kontestua nga ana juaj, vijmë sot me një personalitet tjetër shumë të rëndësishëm siç është Z.Zef Çoba.

Znj.Petani merr fjalën përsëri dhe thotë se më parë u keqkuptua dhe kërkon të sqarohet.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, Z.Ndou , Z.Sokoli dhe Z.Bjanku shprehin dakordësi me pr/aktin.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 7 të rendit të ditës: *Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024.*

Z.Luli sqaron se sipas dakordësisë në mbledhjen e kryesisë nuk është e nevojshme të lexohet ky raport, pasi jeni njohur të gjithë me të dhe bëhet fjalë për veprimtarinë 12 mujore të Këshillit Bashkiak.

Z.Bjanku kërkon që Brenda këtij raporti të kemi një përgjegjësi tjetër secili nga ne, sidomos në lidhje me komisionet dhe mbarëvajtjen e punës së Këshillit.

Z.I.Sokoli mendon se materiali është i mangët, shumë i shkurtër dhe nuk ka një krahasim me vitet e tjera. Nuk ka një analizë të detajuar të punës së Këshillit. Duhet të ketë statistika dhe indikatorë performance edhe për ne këshilltarët.

Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024, hidhet në votim ku rezultojnë **28** vota Pro **0** Kundër **7** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë shtesë: *Pr/ Vendim: "Për miratimin e Kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me Nr.3/455, vol 30, FQ 142 Gjykata e rrethit Shkodër nga Ministria e drejtësisë tek Bashkia Shkodër"*.

Relaton përsëri **Z.Alban Preka**, drejtor në drejtorinë e aseteve në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Anamali shprehet se referuar kartelës së pasurisë, vërej që kjo është pronë e gjykatës. Kërkesa i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë duke mos qenë pronë e saj. Së dyti në relacion, motivacioni juaj është i përgjithshëm. A keni ju një analizë më të detajuar? Gjithashtu ai shprehet se Bashkiak a një numër të madh asetesh. Ai i keni paraqitur ato në raportin e Këshillit se sa eficient keni qenë në përdorimin/shfrytëzimin e tyre dhe pse lind nevoja për të marrë asete të tjera.

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se arsyeja pse po kërkohet kjo godinë është shumë e mirë, pasi flitet për një godinë që sot nuk është funksionale, është në qendër të qytetit dhe mund t'i ofrojë qytetarëve shërbim më të mirë edhe nga aksesimi që ofron.

Ndërhyn **Z.Anamali** duke pyetur se ku është marr informacioni që godina nuk është 100% funksionale? A jeni në dijeni që aty ofron shërbim Përmbarimi shtetëror?

Z.Preka shprehet se Gjykata e rrethit është transferuar, dhe jemi në dijeni për sa thatë. Për më tepër bashkangjitur relacionit keni një shkresë të bashkangjitur. Kurse në lidhje me pronat, ai shton se po punohet dita ditës për të kryer përditësimin e aseteve të Bashkisë, që mos t'i lëmë në harresë dhe t'i kthejmë në dispozicion të qytetarëve.

Ndërhyn **Zv/ kryetari Beka** duke sqaruar më tej arsyen, po punohet për rritje të kapaciteteve të Bashkisë Shkodër, për shtim asetesh.

Po ashtu edhe **Z.Bejleri** sqaron se në lidhje me këtë godinë, duhet të kemi parasysh edhe gjendjen e godinës së Bashkisë për të kuptuar më shumë arsyen e kësaj kërkesë.

Z.Anamali replikon duke thënë se ai pyeti nëse asetet e Bashkisë janë shfrytëzuar 100% dhe pse duhet të merren të tjera.

Z.Bejleri përsëri sqaron se shumë asete të Bashkisë nuk kanë qenë të rregjistruara, kështu që duhet pranoar që është bërë një punë e madhe në këtë drejtim. Gjithashtu **Z.Bejleri** bën një sqarim të detajuar.

Z.Anamali, pyet për konviktin Safet Spahiu se sa është vënë në shfrytëzim.

Përgjigjet përsëri **Z.Bejleri** duke thënë se do shfrytëzohen të dyja godinat paralelisht.

Edhe **Znj.Nika** sqaron në lidhje me pyetjen e **Z.Anamali** duke thënë se pr/vendimi është për shfrytëzim dhe jo për transferim.

Po ashtu edhe **Znj.Mehmetaj** beson se më e rëndësishmja është që po fuqizohet administrimi lokal. Po bëhet një përdorim më i mirë i pronës publike gjithashtu. Për më tepër po ndiqen procedurat ligjore. Edhe nëse asetet e Bashkisë Shkodër nuk janë 100% të shfrytëzuara ekziston e drejta që të kërkojmë transferim prone.

Vijohet me replika mes **Z.Anamali** dhe **Znj.Mehmetaj**.

Z.Luli tërheq vëmendjen duke kërkuar që mos ta kthejmë diskutimin në debat, duhet të ndiqet procedura.

Kurse **Z.Preka** thekson se drejtoria që ai përfaqëson po bën më së miri detyrën në këtë drejtim. Për investimet që priten t'i vijë qytetit duhet të jemi një hap përpara.

Përsëri **Z.Luli** tërheq vëmendjen këshilltarëve duke kërkuar të ruhet etika.

Z.Gj.Sokoli shprehet se po dilet nga rendi i ditës, prandaj kërkon që pr/vendimi të hidhet në votim pa humbur kohë me vogëlsira.

Z.I.Sokoli i jep plotësisht të drejtë kolegut Anamali, duke thënë se kjo po bëhet e tëra në kushte preferenciale. Sese herën e kaluar miratuar godinën e ish-hotel Sportit. Cilat janë të dhënat që të vendoset përdorimi i saj. Nuk kemi asnjë document që justifikon këtë.

Z.Preka thotë se herën e kaluar u kërkuar ndryshim i fushës së përdorimit dhe jo transferim prone.

Z.Shkjau shprehet se nuk sheh asnjë të keqe në këtë rast. Ai shprehet se ne po na merret prona private e jo më ato shtetërore.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, Z.Ndou , Z.Sokoli janë dakort me pr/aktin. Edhe Z.Bjanku shprehet pro në parim , por ai thekson atë çka tha Z.I.Sokoli, që duhet të shërbejë në përmirësim të efijencës së punës së Bashkisë Shkodër.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **31** vota Pro **1** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet tek pika e dytë shtesë e rendit të ditës: *Pr/ Vendim: “Për miratimin e shkëmbimit të pasurive midis Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Brendshme”*.

Përsëri relaton **Z.Preka**. Gjithashtu për këtë pr/vendim sqaron edhe Z.Beka duke theksuar rëndësinë e tij.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, Z.Ndou , Z.Sokoli janë dakort me pr/aktin. Z.Bjanku shprehet se nuk do bëhemi pengesë për të tilla investime por relacioni dhe materiali duhet të jetë më i detajuar në vazhdimësi.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **31** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pr/vendimin: *“Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik, në territorin e Bashkisë Shkodër”*.

Z.Gj.Sokoli thotë se nuk ka nevojë që kjo pikë të relatohet përsëri.

Z.Bjanku merr përsëri fjalën dhe përsërit që siç tha në fillim të mbledhjes pr/vendimi ka nevojë për redaktim dhe nuk ka nevojë që të ketë kërkesë nga ana jonë për këtë. Ne nuk duam asnjëherë të pëhemi pengesë në këtë rast. Nga ana tjetër shton se ai kërkon heqjen e një kriteri absurd të kësaj rregulloreje...

Z.Luli sqaron se çdo kërkesë, sugjerim apo ndryshim duhet të vijë më shkrim ose rregullorja do të miratohet siç është propozuar herën tjetër.

Z.Lesha shprehet se propozimet tuaja **Z.Bjanku** nuk janë thjesht redaktim, por janë thelbësore. Në emër të Bashkisë nuk jemi dakort shprehet ai.

Replikon **Z.Bjanku** duke thënë se ju nuk jeni anëtar i Këshillit **Z.Lesha**.

Z.Luli përsëri thotë se në fillim ju thatë se materiali nuk ka probleme në përmbajtje por gabime në shkrim...

Znj.Mehmetaj gjithashtu shprehet se tani po na thuhet që duhet të ndryshohet edhe përmbajtja.

Z.Bjanku thotë se pse nuk paska të drejtë që si këshilltar të propozojë ndryshime. Kjo është e drejta thelbësore e Këshillit.

Z.Lesha thekson se në seancë nuk mund të propozohen ndryshime.

Po ashtu edhe **Z.Luli** shprehet se nëse 51 këshilltarë të propozonin në seancë ndryshime, imagjinoni si do vijonte mbledhja.

Z.Bjanku thote se përse po bëheni pengesë medeomos në miratimin e kësaj rregulloreje vetëm se keni presionin e dikujt tjetër.

Z.Luli pyet, për çfarë presioni e keni fjalën?

Vijon **Z.Bjanku** duke thënë se në rregullore thuhet që duhet të kalojnë 10 vite nga vdekja e personalitetit, që të vendoset një bust. Ai mendon që ky kriter duhet të hiqet.

Z.Ndou i kërkon **Z.Luli** që të vijojë me votimin duke qënë se të tre grupimet politike ishin dakort në fillim që rregullorja të miratohet pa ndryshime. Për më tepër nuk mendon se i përket këshilltarëve të merren me gabime ortografike , kjo është pjesë e stafit të Bashkisë.

Z.Lesha sqaron edhe njëherë **Z.Bjanku** duke cituar Rregulloren e Këshillit, që në rast ndryshimesh apo propozimesh merret mendimi i Kryetari të Bashkisë dhe i administratës. Në këtë kontekst nuk jam gabim kur them se nuk jemi dakort, pasi propozimet duhen shqyrtuar më parë.

Z.Bjanku thotë se secili nen i çdo rregulloreje apo ligji mund të pësojë modifikim në seanca plenare si në Këshill, si në Parlament. Ne mund ta votojmë kështu por nuk duhet të na përdorni ne si pengesë ndaj qytetarëve. Por në vazhdimësi mund të ketë modifikime.

Znj.Mehmetaj përsëri thotë se në fillim u tha që bëhej fjalë vetëm për gabime ortografike. Ajo kërkon të mos zgjatemi sepse kemi edhe pika të tjera që duhen diskutuar.

Z.Gjergj Sokoli i drejtohet **Z.Bjanku** duke i thënë se kjo nuk duhet të ketë ngjyrimet politike.

Përgjigjet **Z.Bjanku** se për të qënë korrekt ne nuk duhet të përdoremi si alibi, sepse opozita nuk mund të pengojë një gjë të tillë, nuk i kemi as votat e mjaftueshme për këtë. Kemi kërkuar thjesht mirkuptim për të bërë ndryshimet e nevojshme, që kjo rregullore të miratohet në variantin më të mirë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, **Z.Ndou** , **Z.Sokoli** dhe **Z.Bjanku** janë dakort me pr/aktin.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **30** vota Pro **2** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Znj.Pode** duke sjell një shqetësim qytetar në lidhje me punën e firmës që po bën ndërhyrjen në fasdat e pallateve dhe thotë se mendon që duhet t'i tërheqet vëmendja sepse po punon në kushte teknike jo në parametrat e duhur dhe kjo paraqet rezikshmëri.

Znj.Shkrela merr fjalën dhe përsëri shprehet në lidhje me konkursin për instrumentistët e Orkestrës. Me datë 29 dhjetor u bë një koncert madhështor, siç është bërë traditë tashmë "Ndërmendje" me këta instrumentistë. Dhe nuk kuptoj pse duhet të ketë një konkurs në një kohë që ne kemi instrumentistë profesionistë, figura të nderuara. Akoma nuk dihet kush janë fituesit. Për më tepër në buxhet është paraqitur pagesa dhe honoraret e tyre. Ajo kërkon të dijë si do procedohet më tej. Çfarë do bëhet me orkestrën sinfonike që kemi tashmë. Ajo është një vlerë e shtuar e qytetit të Shkodrës.

Përgjigjet **Z.Laço** i cili thotë se ai e ka marrë detyrën në dhjetor dhe përgjigje më të saktë mund të jap **Znj.Smajaj**, drejtoreshë e Kulturës, duke qënë se se është më në brendësi të çështjes.

Fjalën e merr **Znj.Smajaj** duke sqaruar se konkursi në fjalë është një gjë e re për Shkodrën, duke parë që kishte plot kërkesa për të qënë pjesë e Orkestrës, e pamë të nevojshme të hapim një audicion.

Znj.Shkrela replikon duke thënë se kjo do të thotë të fyeri ato instrumentistë profesionistë me një të rënë të lapsit.

Përgjigjet përsëri **Znj.Smajaj** që kjo nuk është e vërtetë sepse të bësh audicion nuk do të thotë të fyesh askënd, thjesht po i japim një shanc edhe talenteve të reja. Audicioni është mynyra më demokratike e të bërit art.

Znj.Shkrela përgjigjet përsëri që audicion bëhet për një vepër të re që do vihet në skenë dhe jo për një orkestër që tashmë e kemi.

Znj.Smajaj shprehet se kontrata e tyre ka përfunduar më 31 dhjetor të 2024 dhe nuk mund të rinovohet automatikisht. Për këtë arsye dhe për ti dhënë mundësi të gjithë atyre që duan të jenë pjesë e saj.

Znj.Shkrela pyet se pse nuk janë shpallur fituesit akoma?

Znj.Smajaj përgjigjet se jemi akoma në proces.

Z.Bjanku thotë se sa për sqarim, instrumentistëve që janë tashmë nga ky audicion i është mohuar 2 muaj honorare. Për më tepër që pagesa është qesharake për të tillë profesionistë.

Përsëri **Znj.Smajaj** thotë se nuk është e vërtetë kjo. Për më tepër honoraret janë të miratuara nga vetë Këshilli, madje ka rritje.

Znj.Shkrela ka edhe një diskutim në lidhje me karnavalet duke thënë se ka patur një buxhet të shtuar në një kohë që nuk kishte asnjë risi apo aktivitet shtesë. Pjesa më e madhe e tyre është mbuluar nga shkollat si çdo vit. Nuk ka asnjë justifikim për një shumë prej 80 milionësh.

Ndërhyn **Z.Shkjau**.

Replikon **Znj.Shkrela** duke thënë se nuk duhet të ndërhyjë kur ajo ka fjalën e saj. Vijon më tej në lidhje me kolektorët, të cilët po zgjasin pafund duke krijuar një kaos në trafik. Kur do përfundojnë punimet, a kemi një përgjigje për qytetarët?

Përgjigjet **Z.Bejleri**, i cili shprehet se punimet me kolektorët kanë patur mjaft probleme , por duhet të mos harrojmë që po bëhet një punë kolosale me tre turne. Ka qënë një sfidë edhe me motin në disfavor. Më vonë do kryhen edhe riasfaltimet.

Shqetësimi tjetër që paraqet **Znj.Shkrela** ka të bëjë me korsitë e biçikletave, që janë kthyer në problem për vendparkimet dhe në dëm të bizneseve. Njerëzit po dëmtohen edhe nga gjobat pa kriter të Policisë Bashkiake dhe ky nuk është vizion. Minimalisht duhet të krijojmë kushte për parkingje.

Znj.Petani në lidhje me karnevalet shprehet se ishte e dukshme atmosfera dhe festa e bukur që u organizua. Ajo nuk beson që shifra që iu referuan kolegët nuk na takon ne si Këshill Bashkiak ta diskutojmë. Kurse në lidhje me korsitë, nuk janë bërë të pa menduara. Gjithsesi ka për të patur ankesa e pakënaqësi nga këshilltarët opozitar. Duhet të jemi falenderues për punën e bërë nga Bashkia.

Z.Doçi shprehet se tregtarët e Rusi, të mos harrojmë se kanë protestuar për kushtet e asaj që pretendoni ju për të qënë falenderues.

Replikon **Z.Shkjau** ndaj Znj.Shkrela duke thënë se duhet të kishte folur për problemin e Hyrjes së Shkodrës, që po dëmton biznese aty.Është e turpshme që prona të vlerësohet për 2 lekë. Janë prona të qytetarëve të Shkodrës dhe janë të ligjshme. Nuk mund të hidhet çdo gjë në tokë. Ai i bën thirrje Kryetarit të bashkisë ta marrin më me qetësi këtë pjesë.

Znj.Nika për qartësim i rikthehet çështjes së karnevaleve dhe korsive të biçikletave. Duhet të mos harrojmë thotë ajo, se kush janë përfituesit këtu. Tek aktivitetet që po bëhen, vëren që ka patur vizitorë nga çdo qytet duke u promovuar kështu si qytet. Ka ardhur koha që Shkodrën ta shohim ndryshe,si dimension ndryshe me ato çka ajo di të ofrojë më së miri me art e kulturë.

Z.Bashi gjithashtu shprehet se korsitë e biçikletave ka vite tashmë që kërkohen. Ai shton se mendon që duhet të mendohet lejimi i parkingjevetë shumta për bizneset. Tjetër shqetësim janë telat e energjisë elektrike, të cilët duhen të pastrohen në disa lagje të qytetit. Kurse përsa i përket Karnevaleve, këtë rradhë kanë qënë shumë herë më të organizuara, duke qënë se Shkodra është bërë epiqendra e tyre. Edhe gjithpërfshirja sjell shumë risi dhe ide. Kjo ka sjellë plot turistë të përkthyer në të ardhura për bizneset.

Z.Anamali sjell një shqetësim të banorëve të rrugës Myzafer Pipa, tek sheshi i Zdrales në lidhje me ndryshimin e sensit të lëvizjes për shkak të punimeve. Ato qytetarë kërkojnë që të gjendet një zgjidhje, pasi ka patur shpeshherë edhe incidente.

Z.I.Sokoli thotë se kjo atmosfera e Karnevaleve është deri diku paradoksale të mendosh që disa shkolla të qytetit nuk kanë lëndë drusore për ngrohje dhe këtë e kam të faktuar. I kërkohet nxënësve të sillen me vehte dru.

Ndërhyn këtu **Z.Shahmani** duke thënë se shkollat në fjalë kanë ngrohje me kaldajë, dhe nuk është aspak e vërtetë kjo që po thuhet. Duket se po bëheni thjesht mediatik duke thënë të pavërteta. Nuk është e drejtë të hidhet baltë mbi punën e dikujt.

Z.Luli i kërkon këshilltarëve të ruajnë etikën.

Vijon **Z.Shahmani** dhe thotë se ka dy vite që nuk është investuar në arsim, siç po punohet tani duke filluar nga higjena, infrastruktura dhe ngrohja.

Z.Dama gjithashtu shprehet se duke qënë vetë pjesë e arsimit dhe përfaqësues i shkollës Ndre Mjeda nuk është aspak e vërtetë ajo çka tha Z.Sokoli për ngrohjen.

Përgjigjet për detajet **Z.Kullaj**, drejtor i DPMOP duke thënë se përta i përket ngrohjes dhe çdo ndërhyrje që kemi bërë në shkolla, mund të jenë lehtësisht të verifikueshme. Ai siguron edhe njëherë që ngrohja është e siguruar për çdo shkollë.

Edhe **Znj.Nika** bën një panoramë të punës së bërë në sistemin arsimor. Ajo thotë se është bërë një punë e mirë që duhet vlerësuar.

Znj.Mehmetaj shprehet se të diskutosh eventët e zhvilluara dhe investimet , i bie të mos duash qytetin tënd. Ajo gjithashtu shpreh një shqetësim në lidhje me Rr.Kaprej, Rajoni nr.5 e cila është në një gjendje jo të mirë. Ajo kërkon që Bashkia ta shoh me prioritet ndërhyrjen në të, pasi ka vite që banorët kërkojnë diçka të tillë.

Z.I. Sokoli thotë se ato nuk janë kundër investimeve dhe ndërhyrjeve por kërkojnë që të jenë të mirëmbenduara. Nuk duhet të bëhet transaksioni i pronës e pastaj dëmshpërblimi. Ato kërkojnë të zbatohet procedura e duhur. Gjithashtu ai thotë se në mbledhjen e kaluar u mor një vendim në lidhje me Q.Shëndetësore, me kushte të papërshtatshme me atë godinë.

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se Q.Shëndetësore ka qënë në kushte skandaloze. Dhe nuk mund të pretendohet që puna e pabërë ndër vite, të realizohet brenda një viti. Po mundohem të bëjmë më të mirën e mundëshme.

Znj.Petani në lidhje me Q.Shëndetësore thotë se është çështje shumë delikate dhe kjo është folur me kohë por nuk është vënë dorë asnjëherë. Unë kam kontaktuar me drejtorin e qendrës dhe ai nuk ka asnjë kundërshtim për kalimin në godinin e re.

Për procedurë **Z.Bjanku** thotë se ne të gjithë jemi për të mirën e qytetarëve nuk duhet të përmenden krahasime politike. Ai shton se drejtori i qendrës nuk është dakort me tranferimin, madje ai ka sjellë edhe një shkresë për këtë.

Znj.Leqejza ndan të njëjtin mendim me Z.Bjanku duke thënë se duhet të fokusohemi në probleme reale dhe jo në diskutime pa fund.Po ashtu i jep të drejtë Z.I.Sokoli duke u shprehur se nuk duhet të punojmë me idenë se me vite gjërat nuk kanë funksionuar dhe kanë qënë të munguara por çdo ndërhyrje apo investim të bëhet me plan dhe me vizion. Pra çdo kritikë të na shërbejë për të punuar më fort.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*


Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 03.03.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 14 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti



KRYETAR

Oltion LULI

